

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE PËR VITIN 2007

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 103 të Rregullores së Kuvendit dhe me nenin 28 të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, pasi u njoh me Raportin për Veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2006, si dhe me raportin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për vlerësimin e veprimtarisë së këtij institucioni, konstaton se:

- veprimtaria e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”;

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka zbatuar rekomandimet e Kuvendit, të shprehura në rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2006”.

Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në drejtim të:

- përmirësimin e kuadrit ligjor për rregullimin dhe zgjerimin e tregut të sigurimeve, veçanërisht atyre të detyrueshme, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve, me qëllim nxitjen e produkteve të sigurimit e të përgjegjësisë në sektorët e karburanteve, ndërtimit, minierave, koncesioneve dhe hotelarisë, mbështetur në kërkesat e tregut dhe në detyrimet që rrjedhin në kuadër të Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian;

- përmbushjes me sukses të procesit të zgjerimit të prezencës së kapitalit të huaj në shoqëritë e sigurimeve gjatë vitit 2007;

- mbikëqyrjes së tregjeve financiare jobankare dhe të performancës së subjekteve që veprojnë në këto tregje nëpërmjet aplikimit të modeleve me bazë risku dhe të një sistemi të strukturuar të analizës financiare, duke synuar identifikimin, parandalimin dhe reduktimin e shkallës së rreziqeve që kërcënojnë stabilitetin e tregut dhe interesat e konsumatorëve;

- përgatitjes së akteve nënligjore për investimin e provigjoneve, praktikave të trajtimit dhe vlerësimit të dëmeve në sigurime, marrëveshjet e risigurimit, veprimtarinë e ndërmjetësve në sigurime;

- rritjes së shkallës së transparencës të operatorëve në treg nëpërmjet përmirësimit të sistemit të tyre të raportimit;

- vendosjes së marrëdhënieve të bashkëpunimit me të gjithë aktorët dhe institucionet në vend, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në tërheqjen e praktikave më të mira;

- rritjes së shkallës së informimit të konsumatorëve për produktet e ofruara nga shoqëritë që ushtrojnë veprimtari në këto tregje, nëpërmjet mbështetjes nga një sistem elektronik i avancuar komunikimi;

- përmirësimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale, nëpërmjet zhvillimit të një strukture efektive, politikave të përzgjedhjes së burimeve njerëzore dhe trajnimit të vazhdueshëm të stafit.

Kuvendi kërkon që për vitin 2008 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, midis të tjerave, të përqendrojë punën edhe në këto drejtime:

- plotësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e nënligjor të institucionit, në përputhje me kërkesat e tregjeve, praktikave të vendeve të tjera dhe direktivat e Bashkimit Europian, me synim zgjerimin e mëtejshëm të tregjeve të sigurimeve dhe skemave private të pensioneve;

- rritjen e masës dhe cilësisë së mbikëqyrjes së tregjeve financiare jobankare për të zvogëluar dhe parandaluar rreziqet ndaj stabilitetit të tyre;

- bashkëpunimin me operatorët e tregjeve financiare jobankare për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe marrjen e masave organizative, me synim përmirësimin e raportit dëme/prime; uljen e shpenzimeve administrative dhe rritjen e efektivitetit të kapitalit;

- bashkëpunimin me Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Konkurrencës për garantimin e një tregu të lirë, konkurrues e transparent, në mbrojtje të interesave të klientëve;

- hartimin dhe miratimin e legjislacionit të ri, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare për sigurimin e detyrueshëm dhe për pensionet private suplementare;
- fillimin e punës për hartimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit për mbrojtjen nga katastrofat;
- rritjen e bashkëpunimit me biznesin dhe përmirësimin e legjislacionit për të zgjeruar gamën e produkteve të siguruara prej tij, veçanërisht të produkteve të sigurimit vullnetar.

5 maj 2008